



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
Kryetari

Nr 6018 pot

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, e-mail: burimetnjerzore@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400147

VENDIM

Nr. 291 datë 24/5/2016

“Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike per stacionet e plazhit”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, Ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, Ligji Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Ligji nr.8224 dt.22.5.1997 “Per organizimin dhe funksionimin e policise se bashkise” VKM. Nr.1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, VKM Nr. 369, datë 18.05.2016, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtatisë së stacionit të plazhit”, VKB nr.1 datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”,

VENDOSA:

1. Miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e stacioneve të plazhit, zonës së plazhit për aktivitete zbavitëse dhe të shërbimeve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori i njësisë administrative Velipojë dhe të gjitha strukturat e përfshira në këtë rregullore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

KRYETARI

Adriana Ademi
ADRIANA ADEMI

